
ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Rritet transparenca formale në universitete publike



Numri i dokumenteve të publikuara në muajt janar dhe shtator 2019

Norwegian Embassy

KCSF

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Lënda:

“Transparenca formale e universiteteve publike”

Afati i shtatorit

UNIVERSITETET NË PROVIM

Transparenca formale është hapi i parë drejt transparencës së mirëfilltë dhe llogaridhënies së institucioneve publike të cilat burim të vetëm të të ardhurave e kanë buxhetin e shtetit.

Me transparencë formale në këtë dokument kuptohet ofrimi i qasjes formale në informacion nga ana e universiteteve publike për publikun përmes ueb faqeve të tyre.

ORCA në këtë hulumtim ka grumbulluar të dhëna mbi ekzistencën e 27 dokumenteve nga universitetet publike, të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të tyre.

Të dhënat janë grumbulluar nga ueb faqet zyrtare të 7 universiteteve publike të vendit.

Në kuadër të hulumtimit ne kemi arritur ta bëjmë indeksimin e transparencës në kontekstin e shpjeguar dhe kemi arritur që këtë indeksim t’ia përshtasim sistemit të notimit në arsimin e lartë në vendin tonë. Asnjë nga universitetet publike nuk ka marrë notën 10 e as 9.

Nga hulumtimi i njëjtë i shkurtit 2019, universitetet kanë shënuar përmirësim. Universiteti i Prishtinës mbetet i njëjtë me notën 8. Universiteti i Pejës, Mitrovicës, dhe ai i Prizrenit kanë shënuar përmirësim nga nota 7 në notën 8. Universiteti i Gjilanit nga nota 6 ka marrë 7 në këtë afat, ndërsa Universiteti i Gjakovës nga nota 5 (rënie nga provimi) ka marrë notën 7. Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Ferizajit ka rënë përsëri nga provimi.

Universitetet publike nuk i publikojnë buxhetet e tyre, me përjashtim të buxhetit të Universitetit të Pejës i cili u gjet në një raport financiar tre-mujor, të publikuar në uebfaqe. Poashtu raportin student për kokë mësimdhënësi shumica e këtyre universiteteve nuk e tregojnë në ueb faqe.

Shqetësim serioz mbetet mospërditësimi, ashtu edhe mungesa e dokumenteve të mëhershme sidomos të vendimeve të Senatit, Këshillit Drejtues dhe të Rektorit.

Shtator 2019, Prishtinë

Lista e rezultateve të provimit nga lënda “Transparenca formale e universiteteve publike” - Afati i shtatorit								
Universiteti i:		**Prishtinës**	**Pejës**	**Mitrovicës**	**Prizrenit**	**Gjilanit**	**Gjakovës**	**Ferizajit**
1	Raporti student/mësim-dhënës	✓	X	✓	X	X	X	X
2	Statuti i Universitetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Plani strategjik	✓	✓	✓	✓x	✓	✓x	X
4	Kodi i etikës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X
5	Rregullorja për masat disiplinore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X
6	Rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik	✓	✓x	✓	✓x	✓	X	X
7	Rregullorja për bashkëpunëtorë	✓	✓	X	✓	✓	X	X
8	Buletinet	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X
9	CV-të e stafit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X
10	Rregullorja për të ardhura personale	X	✓	✓x	✓x	✓x	✓x	X
11	Buxheti	X	✓	X	X	X	✓x	X
12	Rregullorja për zgjedhjet studentore	✓	✓	✓x	✓	✓	✓	X
13	Përbërja e Parlamentit Studentor	✓	✓x	✓	✓	✓	✓	✓
14	Përbërja e rektoratit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓x
15	Përbërja e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✓	✓x	✓
16	Përbërja e Senatit	X	✓	✓	✓	✓	✓	✓
17	Vendimet e Senatit	✓	X	✓	✓	X	✓x	X
18	Vendimet e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	X	✓x	X
19	Vendimet e Rektorit	✓	✓	X	X	X	X	X
20	Vendimet e akreditimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X
21	Rregullorja për studimet BA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
22	Rregullorja për studimet MA	✓	✓	✓	✓	X	X	X
23	Rregullorja për studimet PhD	✓	X	X	X	X	X	X
24	Rregullorja për SEMS	✓	X	X	✓	X	✓	X
25	Rregullorja për sigurimin e cilësisë	✓	✓	✓	✓x	✓	✓	X
26	Planprogramet	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
27	Info për bursa/punësim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Indeksi		**24/27**	**23/27**	**22/27**	**23/27**	**19/27**	**21/27**	**8/27**
Nota		**8**	**8**	**8**	**8**	**7**	**7**	**-**

Këto janë notat përfundimtare për këtë vit akademik.